
RREGULLORE (KE) NR. 1161/2005 E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT, DATË 6 KORRIK 2005, "PËR PËRPILIMIN E LLOGARIVE JOFINANCIARE TREMUJORE SIPAS SEKTORIT INSTITUCIONAL"

PARLAMENTI EVROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin themelues të Bashkimit Evropian dhe në veçanti nenin 285 paragrafi 1 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit,

Duke pasur parasysh opinionin e Bankës Qendrore Evropiane¹,

Duke vepruar në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 251 të Traktatit²,

Meqë:

1. Plani i veprimit për kërkesat statistikore të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar (BEM) i miratuar nga Këshilli Ekonomik dhe Financiar në shtator 2000, përcakton se nevojitet me urgjencë një grup i kufizuar i llogarive tremujore të sektorëve dhe se kjo duhet bëhet brenda 90 ditëve nga fundi i tremujorit përkatës.

2. Raporti i përbashkët i Këshillit të Ekonomik dhe Financiar dhe i Komisionit për Këshillin Evropian për statistikat dhe treguesit e zonës euro, siç miratohet nga Këshilli Ekonomik dhe Financiar më 18 shkurt 2003, thekson se veprimet me përparësi të lartë në disa fusha, duke përfshirë llogaritë kombëtare tremujore sipas sektorit institucional, duhet të zbatohen plotësisht deri më 2005.

3. Analiza e lëvizjeve ciklike në ekonominë e Bashkimit Evropian dhe zbatimi i politikës monetare brenda BEM-së kërkon statistika makroekonomike për sjelljen ekonomike dhe ndërlihdjen e sektorëve individualë institucionalë që nuk mund të identifikohen në të dhënat e hartuara në nivelin e ekonomisë në tërësi. Prandaj, lind nevoja për krijimin e llogarive tremujore sipas sektorit institucional, për Bashkimin Evropian në tërësi dhe për zonën euro.

4. Krijimi i këtyre llogarive është pjesë e qëllimit të përgjithshëm për hartimin e një sistemi llogarish vjetore dhe tremujore për Bashkimin Evropian dhe për zonën euro. Sistemi përfshin komponentët kryesorë makroekonomikë dhe llogaritë financiare dhe jofinanciare sipas sektorit institucional. Qëllimi është arritja e konsistencës në të gjitha këto llogari dhe, duke pasur parasysh llogaritë e pjesës tjetër të botës, mes bilancit të pagesave dhe të dhënave kombëtare të llogarive.

5. Përpilimi i llogarive evropiane sipas sektorit institucional, në përputhje me parimet e sistemit evropian të llogarive kombëtare dhe rajonale në BE, siç përcaktohet në Rregulloren e

Këshillit (KE) nr. 2223/96³, kërkon transmetimin e llogarive kombëtare tremujore sipas sektorit institucional nga shtetet anëtare. Megjithatë, llogaritë evropiane duhet të reflektojnë ekonominë e zonës evropiane në tërësi dhe mund të ndryshojnë nga komponentët e thjeshtë të llogarive të shteteve anëtare. Në veçanti, objektivi është marrja në konsideratë e transaksioneve të institucioneve dhe organeve të Bashkimit Evropian në llogaritë e zonës përkatëse (Bashkimi Evropian ose zona euro, cilado qoftë e zbatueshme).

6. Nxjerrja e statistikave specifike të BE-së rregullohet nga dispozitat e përcaktuara në rregulloren e Këshillit (KE) nr. 322/97, datë 17 shkurt 1997, "Për statistikën e BE-së"⁴.

7. Meqenëse objektivi i kësaj rregulloreje, i cili është hartimi i llogarive tremujore jofinanciare sipas sektorit institucional për Bashkimin Evropian dhe zonën euro, nuk mund të arrihet në masën e mjaftueshme nga shtetet anëtare dhe si rezultat, për arsye të shkallës dhe të ndikimeve mund të arrihet më mirë në nivel BE-je, BE-ja mund të miratojë masa në përputhje me parimin e subsidiaritetit, siç përcaktohet në nenin 5 të traktatit. Në përputhje me parimin e proporcionalitetit, sipas përcaktimit në atë nen, kjo rregullore nuk shkon përtej asaj që është e nevojshme për arritjen e këtij objektivi. Në veçanti, nëse shtetet anëtare japin një kontribut të papërfillshëm në raport me totalin evropian, atyre nuk do t'ju kërkohej të raportojnë detajet e plota të të dhënave.

8. Masat e nevojshme për zbatimin e kësaj rregulloreje duhet të miratohen në përputhje me Vendimin e Këshillit 1999/468/KE, datë 28 qershor 1999, "Për përcaktimin e procedurave për ushtrimin e kompetencave zbatuese që i delegohen Komisionit"⁵.

9. Janë këshilluar, Komiteti i Programit Statistikor i ngritur me Vendimin e Këshillit 89/382/KEE, Euratom⁶ dhe Komiteti i Statistikave Monetare, Financiare dhe Bilancit të Pagesave i ngritur me Vendimin e Këshillit 91/115/KEE⁷,

MIRATOJNË KËTË RREGULLORE:

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore siguron një kuadër të përbashkët për kontributet e shteteve anëtare për përpilimin e llogarive jofinanciare tremujore evropiane sipas sektorit institucional.

Neni 2

Transmetimi i llogarive jofinanciare tremujore sipas sektorit institucional

1. Shtetet anëtare i transmetojnë Komisionit llogaritë jofinanciare tremujore sipas sektorit institucional, siç specifikohet në shtojcë, përveç rastit të parë, zërat P.1, P.2, D.42, D.43, D.44, D.45 dhe B.4G.

2. Në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 8 paragrafi 2, duhet miratuar një afat kohor për transmetimin e zërave P.1, P.2, D.42, D.43, D.44, D.45 dhe B.4G përkatësisht dhe çdo vendim për të kërkuar ndarjen e transaksioneve të renditura në shtojcë sipas sektorit të

ngjashëm. Çdo vendim i tillë nuk miratohet para raportimit të Komisionit pranë Parlamentit Evropian dhe Këshillit për zbatimin e kësaj rregulloreje në përputhje me nenin 9.

3. Të dhënat tremujore të përmendura në paragrafin 1 i dërgohen Komisionit të paktën 90 ditë kalendarike pas përfundimit të tremujorit me të cilin ato lidhen. Gjatë në periudhe kalimtare tre vjeçare nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, të dhënat tremujore të përmendura në paragrafin 1 i dërgohen Komisionit të paktën 95 ditë kalendarike pas përfundimit të tremujorit me të cilin ato lidhen. Çdo rishikim i të dhënave për tremujorë të mëparshëm transmetohet në të njëjtën kohë.

4. Koha e transmetimit e specifikuar në paragrafin 3 mund të rregullohet, me pesë ditë maksimumi, në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 8, paragrafi 2.

5. Transmetimi i parë i të dhënave tremujore lidhet me të dhënat për tremujorin e tretë të vitit 2005. Shtetet anëtare i dërgojnë këto të dhëna jo më vonë se 3 janari 2006. Transmetimi i parë përfshin të dhëna retrospektive për periudhat nga tremujori i parë i vitit 1999.

Neni 3

Detyrimet e raportimit

1. Të gjitha shtetet anëtare i transmetojnë të dhënat e përshkruara në shtojcë, në lidhje me sektorin e pjesës tjetër të botës (S.2) dhe sektorin e administratës publike (S.13). Një shtet anëtar, prodhimi i brendshëm bruto i të cilit me çmimet korrente normalisht përfaqëson mbi 1% të totalit përkatës të BE-së, i transmeton të dhënat e përshkruara në shtojcë për të gjithë sektorët institucionalë.

2. Komisioni përcakton përqindjen e totalit të prodhimit të brendshëm bruto të Komisionit me çmimet korrente që përfaqëson normalisht prodhimi i brendshëm bruto i një shteti anëtar, siç përcaktohet në paragrafin 1, në bazë të mesatares aritmetike të të dhënave vjetore të tre viteve të fundit të transmetuara nga shtetet anëtare.

3. Përqindja (1%) e totalit të BE-së e përmendur në paragrafin 1 mund të rregullohet në përputhje me procedurat e përmendura në nenin 8, paragrafi 2.

4. Derogimet nga kjo rregullore mund të pranohen nga Komisioni, nëse sistemi kombëtar statistikor kërkon përshtatje të konsiderueshme. Këto derogime nuk zgjasim më shumë se tre vjet nga data e hyrjes të kësaj rregulloreje apo nga ajo e zbatimit të masave të miratuara në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 8, paragrafi 2.

Neni 4

Përkufizime dhe standarde

Standardet, përkufizimet, klasifikimet dhe rregullat e kontabilitetit për të dhënat e transmetuara për qëllime të kësaj rregulloreje janë ato që përcaktohen në Rregulloren (KE) nr. 2223/96 (në vijim referuar si Rregullorja ESA).

Neni 5

Burimet e të dhënave dhe kërkesat për konsistencë

1. Shtetet anëtare përpilojnë informacionin e kërkuar në këtë rregullore duke përdorur të gjitha burimet që ata i konsiderojnë të përshtatshme, duke i dhënë prioritet informacionit të drejtpërdrejtë, si burimet administrative apo sondazhet e ndërmarrjeve dhe familjeve.

Nëse informacionet e drejtpërdrejta nuk mund të mblidhen, sidomos për të dhënat retrospektive të kërkuara në bazë të nenit 2, paragrafi 5, mund të transmetohen përlllogaritjet më të mira.

2. Të dhënat e transmetuara nga shtetet anëtare për qëllime të kësaj rregulloreje janë konsistente me llogaritë jofinanciare tremujore të administratës publike dhe me komponentët kryesore të ekonomisë në total, të transmetuara pranë Komisionit në bazë të programit të transmetimit të të dhënave të rregullores ESA.

3. Të dhënat tremujore të transmetuara nga shtetet anëtare për qëllime të kësaj rregulloreje rakordohen me të dhënat përkatëse vjetore të transmetuara në bazë të programit të transmetimit të të dhënave të rregullores ESA.

Neni 6

Standardet e cilësisë dhe raportet

1. Shtetet anëtare marrin masat e nevojshme për të garantuar që cilësia e të dhënave të transmetuara përmirësohet me kalimin e kohës në mënyrë që të përmbushë standardet e zakonshme të cilësisë që do përcaktohen në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 8, paragrafi 2.

2. Brenda një viti nga transmetimi i parë i të dhënave, shtetet anëtare i sigurojnë Komisionit përshkrimin e përditësuar të burimeve, mënyrave dhe trajtimeve statistikore të përdorura.

3. Shtetet anëtare informojnë Komisionin për ndryshimet e konsiderueshme metodologjike ose për ndryshime të tjera që mund të ndikojnë të dhënat e transmetuara, jo më vonë se tre muaj pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve.

Neni 7

Masat zbatuese

Masat zbatuese përcaktohen në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 8, paragrafi 2. Këto masa përfshijnë:

a) përcaktimin e afatit për transmetimin e zërave P.1, P.2, D.42, D.43, D.44, D.45 dhe B.4G në përputhje me nenin 2, paragrafi 2;

b) kërkesën për ndarjen e transaksioneve të treguara në shtojcë sipas sektorit të ngjashëm në përputhje me nenin 2, paragrafi 2;

c) rishikimin e afatit të transmetimeve tremujore në përputhje me nenin 2, paragrafi 4;

d) rregullimin e përqindjes (1%) të BE-së në tërësi për të përcaktuar detyrimin e transmetimit të të dhënave për të gjithë sektorët institucionalë në përputhje me nenin 3, paragrafi 3;

e) përcaktimin e standardeve të cilësisë së të dhënave në përputhje me nenin 6, paragrafi 1.

Neni 8

Procedura e Komitetit

1. Komisioni asistohet nga Komiteti i Programit Statistikor.

2. Aty ku përmendet ky paragraf, zbatohen nenet 5 dhe 7 të Vendimit 1999/468/KE, duke pasur parasysh dispozitat e nenit 8 të tij.

Periudha e përmendur në nenin 5 paragrafi 6 të Vendimit 1999/468/KE është tre muaj.

3. Komiteti miraton vetë rregulloren e tij të brendshme.

Neni 9

Raporti për zbatimin e rregullores

Brenda pesë viteve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, Komisioni i dorëzon Parlamentit Evropian dhe Këshillit një raport për zbatimin e saj.

Në veçanti ky raport:

a) siguron informacion për cilësinë e statistikave të krijuara;

b) vlerëson përfitimet në favor të BE-së, shteteve anëtare, dhe të ofruesve dhe përdoruesve të informacionit statistikor nga statistikat e krijuara në krahasim me kostot e tyre;

c) identifikon fushat për përmirësim dhe ndryshime të mundshme që konsiderohen të nevojshme në kuadër të rezultateve të marra.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 20 ditë pas botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Kjo rregullore është detyruese në tërësinë e saj dhe drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjitha shtetet anëtare.

Nënshkruar në Strasburg, më 6 korrik 2005.

Për Parlamentin Evropian

Për Presidentin

J. BORRELL FONTELLES

Për Këshillin

Presidenti

J. STRAW

SHTOJCA

TRANSMETIMI I TË DHËNAVE

-
1. *Gazeta Zyrtare C 42, 18.2.2004, f. 23.*
 2. Qëndrimi i Parlamentit Evropian, datë 30 mars 2004 (*Gazeta Zyrtare C 103 E, 29.4.2004, f. 141*), Qëndrimi i Përbashkët i Këshillit i 8 marsit 2005 (ende i pabotuar në *Gazetën Zyrtare*) dhe Qëndrimi i Parlamentit Evropian i 26 majit 2005 (ende i pabotuar në *Gazetën Zyrtare*).
 3. *Gazeta Zyrtare L 310, 30.11.1996, f. 1.* Rregullore e ndryshuar së fundmi me Rregulloren (KE) nr. 1267/2003 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (*Gazeta Zyrtare L 180, 18.7.2003, f. 1*).
 4. *Gazeta Zyrtare L 52, 22.2.1997, f. 1.* Rregullore e ndryshuar me rregulloren (KE) nr. 1882/2003 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (*Gazeta Zyrtare L 284, 31.10.2003, f. 1*).
 5. *Gazeta Zyrtare L 184, 17.7.1999, f. 23.*
 6. *Gazeta Zyrtare L 181, 28.6.1989, f. 47.*
 7. *Gazeta Zyrtare L 59, 6.3.1991, f. 19.*
-